REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 6, datë 21/03/2005

"PËR RIORGANIZIMIN E TEATRIT TË CIRKUT, TEATRIT TË ESTRADËS, QENDRËS REKREATIVE "TIRANA" NË QENDRËN KULTURORE "TIRANA" DHE NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE"

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 (gërma ç), Ligjit Nr.8578, dt.10/02/2000 "Për teatrin", kreu IV, neni 38, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.551, dt.07/11/2002 "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive te qeverisjes vendore, për efekt page, përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", pika 14, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë riorganizimin e bashkimin administrativ të Teatrit të Cirkut, Teatrit të Estradës dhe Qendrës Rekreative "Tirana", duke krijuar Qendrën Kulturore "TIRANA".

2. Në mbështetje të pikës 1 të këtij Vendimi, miratohet struktura organizative, numri i punonjësve (60), sipas organigramës bashkëlidhur.

3. Niveli i pagave të Qendrës Kulurore "TIRANA" është sipas Lidhjes Nr.6 bashkëlidhur.

4. Për zbatimin e pikës 1 të këtij Vendimi, Teatri i Cirkut, Teatri i Estradës, Qëndra Rekreative "Tirana" dhe Qendra Kulturore "TIRANA" të kryejnë inventaret dhe veprimet e nevojshme kontabile e financiare, si dhe çdo veprim tjetër juridik të detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi, rezultat i këtij bashkimi administrativ.

5. Zbatimi i pikës 1, 2 dhe 3 të këtij Vendimi, përfshirë edhe efektet financiare të tyre fillojnë më datë 01/04/2005 dhe do të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2005, ndërsa zbatimi i pikës 4 të këtij Vendimi fillon menjëherë dhe deri në plotësimin e të gjitha detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi.

6. Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, të hartohet Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Qendrës, e cila të paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak të Tiranës, brënda muajit Qershor 2005.

7. Pika 1 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.47, dt.1/10/2004 "Mbi një shtesë të strukturës së Cirkut të Tiranës dhe buxhetit të tij me qëllim riorganizimin e Orkestrës Frymore të Tiranës", Vendimi i Keshillit Bashkiak Nr.111, dt.24/06/1999 "Për miratimin e Strukturës Organizative të Qendrës Rekreative "Tirana", si dhe të gjitha aktet dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë Vendim, shfuqizohen.

8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Administrimit të Aseteve, Teatri i Cirkut, Teatri i Estradës, Qendra Rekreative "Tirana" dhe Qendra Kulturore "TIRANA" për zbatimin e këtij Vendimi.

9. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI